VENDIM
Nr. 482, datë 10.7.2019

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 419, DATË 14.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E AFATEVE DHE TË SKEMËS SË SHPËRNDARJES SË FONDEVE TË DËMSHPËRBLIMIT PËR ISH-TË DËNUARIT POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 32, të ligjit nr. 9831, datë 12.11.2007, "Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 419, datë 14.4.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Në bazë të buxhetit vjetor të vënë në dispozicion, fondi i dëmshpërblimit të ish-të dënuarve politikë nga regjimi komunist ndahet në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit, me kusht që kësti i dëmshpërblimit të mos jetë më i madh se 1 000 000 (një milion) lekë.".

2. Pika 2 shfuqizohet.

3. Në pikën 4, pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i dytë, me këtë përmbajtje:

"Për të gjitha subjektet përfituese parësore, kur vlera totale e dëmshpërblimit është mbi 8 000 000 (tetë milionë) lekë vijohet me pagesën e kështit pasardhës deri në shpërndarjen e plotë të shumës së miratuar. Në rast se vlera totale e miratuar për të gjithë përfituesit është deri në 1 000 000 (një milion) lekë, shpërndarja e dëmshpërblimit kryhet me një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.".

4. Paragrafi i fundit, i pikës 6, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Me kryerjen e pagesës së dëmshpërblimit për të gjithë përfituesit, brenda kështit më të ulët fillon pagesa e kështit pasardhës. Ky mekanizëm përsëritet deri në shpërndarjen e plotë të shumës së dëmshpërblimit.".

5. Kudo në vendim, emërtimet "Ministria e Financave", "Ministri i Financave", "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë" zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët "ministria përgjegjëse për financat", "ministri përgjegjës për financat", "ministria përgjegjëse për çështjet sociale".

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama